



**RAPORTI VJETOR
PËR PUNË I SHKOLLËS
SHMQSH “CVETAN DIMOV” SHKUP
PËR VITIN SHKOLLOR 2022/2023**

SHKUP, GUSHT 2023

PËRMBAJTJA

| | |
|---|----|
| 1. Letër njoftimi i shkollës..... | 3 |
| 2. Hyrje..... | 3 |
| 3. Organizimi i punës në shkollë..... | 6 |
| 3.1. Struktura organizative dhe organizimi | |
| 3.2. Përgatitja materiale teknike | |
| 3.3. Organizimi i procesit mësimor | |
| 3.4. Kuadri mësimor dhe jomësimor | |
| 3.5. Realizimi i programit vjetor për punë | |
| 3.6. Raporti për suksesin dhe rregullueshmërinë e nxënësve | |
| 3.7. Shpërblime dhe lavdrata | |
| 3.8. Përmbytje të programuara nga shkolla | |
| 3.9. Raport për maturën shtetërore dhe përfundimtare | |
| 4. Realizimi i mësimit..... | 18 |
| 5. Aktivitetet jashtë mësimore të realizuara në vitin shkollor..... | 20 |
| 6. Puna e organeve menaxheriale dhe profesionale..... | 24 |
| 6.1. Këshilli i Shkollës | |
| 6.2. Këshilli i arsimtarëve | |
| 6.3. Këshilli i viteve dhe paraleleve | |
| 6.4. Këshilli i prindërve | |
| 6.5. Kujdestarët e klasave | |
| 6.6. Ekipi menxhues dhe profesional | |
| 6.7. Aktivitetet profesionale | |
| 7. Burimet financiare | 26 |
| 8. Bashkëpunimi me mediat..... | 27 |

1. LETËR NJOFTIMI I SHKOLLËS

❖ Të dhënat e përgjithshme

Emri i shkollës: Shkolla e Mesme e Qytetit të Shkupit “Cvetan Dimov“ Shkup
Adresa: Rr.Xhon KenediNr.16 Komuna: ÇairVendi: Shkup
Tel: 02 2611 530 Faks: 02 2616 354 E-mail: sug-s-cvetandimov-schools.mk
Themeluar nga: Qyteti i Shkupit
Verifikimi – numri i protokolit: 132/06
Viti i verifikimit: 11.04.2006
Vendndodhjen e shkollës: shkolla është vendosur në komunën e Çairit, e cila ka të zhvilluar infrastrukturën.
U.d. Drejtor: Visar Durak

2. Hyrje

Formimi dhe puna e shkollës që nga viti shkollor 1925/26 paraqet një lloj vazhdimi apo rritje e shkollës ekzistuese dyvjeçare tregtare në shkallë të Akademisë, me prerogativat e Akademisë shtetërore tregtare në Beograd. Iniciativa për themelimin të Akademisë ka ardhur nga drejtoria e Dhomës së atëhershme tregtare-industriale së Shkupit, pas së cilës u regjistrua gjenerata e parë të nxënësve në vitin shkollor 1925/26.

Pas okupimit të Maqedonisë nga ana e Bullgarisë në vitin 1941 Akademia tregtare është transformuar në Gjinnaz tregtar. Në vit të parë janë regjistruar nxënës që kanë kryer vitin e tretë gjinnaz, ndërsa mësimi në Gjinnazin tregtar ka pasur kohë zgjatje prej 5 vitesh. Shkollasi një qendër shkollës tregtare-Shkup është themeluar me Vendim të Këshillit të Arsimit të RM me 28.10.1954.

Sa i përket arsimit të gjinnazit, më 07.11.1894, në Maqedoni u formua gjinnaz mashkullor i cili ka vazhduar me punë deri më shkatërrimin e Jugosllavisë së vjetër (e krijuar para luftës së dytë botërore). Ky gjinnaz ka vazhduar me punë edhe gjatë luftës së dytë botërore, por nën kushte të vështira.

Në vitin 1945 gjinnazi mashkullor ka marrë emrin “Cvetan Dimov” edhe ky emër mbetet deri më vitin 1952. Që nga viti shkollor 1952/53, në këtë shkollë fillojnë të regjistrohen edhe nxënës nga gjinia femërore, derisa gjinnazi “Cvetan Dimov” e merr imazhin e gjinnazit për të dy gjinitë, dhe kështu vazhdon deri më vitin shkollor 1985/86 godina. Prej atëherë, në këto hapësira (ndërtesë) vendoset shkolla e mesme shtetërore e tanishme “Cvetan Dimov”.

Në vitin shkollor 1980/81, në këtë shkollë transferohen paralele tregtare në gjuhën shqipe të cilat deri atëherë kanë punuar në suaza të gjimnazit "Zef Lush Marku". Të njëjtin vit u inkuadrua profil i ri arsimor i quajtur teknik - aranzhues, me nga një paralele për vit shkollor.

Duke pas parasysh prejardhjen historike të shkollës, që nga viti shkollor 1998/99, në shkollën arsimohen edhe nxënës nga arsimi të gjimnazit. Më këtë vazhdojnë traditat e dy shkollave të para dhe mjaft të vjetra sipas themelimit e tyre, të formuara në Republikën e Maqedonisë.

Që nga viti shkollor 2004/05 në këtë shkollë inkuadrohet profili arsimor *Asistent për tregti dhe marketing* që paraqet zëvendësim i përshtatshëm i profilit *Shitës*, si profil i cili përshtatet me zhvillimin bashkëkohor shoqëror. Në këtë mënyrë shkolla e vazhdon traditën në përcjellje të trendeve bashkëkohore.

Në vitin shkollor 2005/ 06 u zbatua ndryshim i planit dhe programit mësimor dhe ndryshoi titulli *Asistent për tregti dhe marketing* dhe e morri titullin e ri *Teknik për tregti dhe marketing*. Në të njëjtin vit shkollor në shkollë regjistrohen edhe nxënës të profilit *Teknik për ekonomi*.

Në vitin shkollor 2013/14 drejtimi ekonomiko-tregtaro juridik u pasurua edhe me një profil të ri me kohëzgjatje trevjeçare-referent për shërbime të shitjes.

Në vitin shkollor 2015/16 u hap edhe një drejtim i ri arsimor konkretisht drejtimi Shëndetsësor me mësim në gjuhën shqipe me profile:motër medicinale,teknik dhëmbësh dhe teknik farmaceutik laboratorik,ndërsa në drejtimin ekonomik profil i ri –teknik juridik me vijim katërvjeçar.

Që nga fillimi e deri sot, shkolla i kryen detyrat e parashtruara me sukses. Nxënësit që kanë kryer arsimin të gjimnazit dhe ata që kanë kryer drejtim profesional tregtar, japin kontribute të rëndësishme në avancimin e jetës së përgjithshme në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Shumë nga tyre, sot janë afaristë të njohur, persona publik dhe qytetarë të dalluar.

SMQSH"Cvetan Dimov" në Shkup është një shkollë moderne me mësimëdhënie moderne dhe programe në të cilat mësimi është në dy gjuhë: shqipe dhe turke.Shkolla ka arsimim katërvjeçar dhe trevjeçar kryesisht arsim profesional me dy drejtime:Drejtimi shëndetsi dhe mbrojtje sociale katervjeçare me profile:motër medicinale,teknik farmaceutik dhe teknik dhëmbësh;Ekonomi tregti dhe juridik me vijim katërvjeçar ne gjuhën shqipe profilet arsimore:teknik ekonomik ,administrator biznesi dhe teknik juridik si dhe arsimim trevjeçar - profili referent për shërbime të shitjes ,ndërsa në gjuhën turke arsim katërvjeçar profili arsimor teknik ekonomik.

Misioni

SHMQSH “Cvetan Dimov“Shkupi është mjedisinë të cilin janë krijuar dhe praktikuar kushte maksimale për shfrytëzimin efikas arsimor të teknikës dhe teknologjisë që do të ndihmojnë çdonxënësi ipër të arrihur më shumë që mundën. Ajo u mundëson pas mbarimit të vazhdojnë me arsimim ose në mënyre aktive të kyqen në sfidat e tregut të punës dhe në shoqërinë e të jetuarit. Shkolla përfaqëson një mjedis të sigurt në të cilën ka një marrëdhënie partneritet me familjen e nxënësit.

Qëllimi i shkollës është që nxënësve të ju mundësoj një zhvillim individual optimal në përputhshmëri me predispozicionet e tyre dhe moshën, zhvillimin e njëdijë të përgjegjësisë, respektimi i të drejtave civile dhe detyrimeve, mirëkuptimit të ndërsjellë, tolerancës, të drejtat e njeriut, të jetuarit në bashkësi, për gatitshmëria për iniciativë dhe të krijimtarisë, për reagim të shpejt dhe të përshtatshme për t'iu për gjigjur ndryshimeve, zhvillimin e duhur fizike dhe mendore dhe përgjegjësinë përshëndetin e tyre.

Shkolla ka përcaktuar parimet e mëposhtme që janë të bazuara në punë të përgjithshme:

- përmisimi i klimës në shkollë
- përgaditjet didaktiko-metodike për arsimtarët për realizimin më të suksesshëm të planëprogramit mësimor, a me atë nxënësit të përfitojnë dituri kualitative.
- shkallë lartë e monitorimit pedagogjike, menaxhimin dhe drejtimin e të gjitha fushave të veprimtarisë arsimore-edukative
- bashkëpunim më të madh ndërmjet aktivevetë këshillit profesional dhe të këshillit të klasave në drejtim më të lartë të cilësive edukativo-arsimore
- nxënësit të kyqen në projekte me qëllim të përfitimit të diturive për eksponimin e aftësive individuale
- Shfrytëzimin efikas dhe profesional të teknologjisë kompjuterike
- Promovimii bashkëpunimit me prindërit, partnerët e biznesit dhe komunitetin lokal
- rritjen e ndërgjegjësisimit ekologjik në mesin e nxënësve

Vizioni

Motoja e shkollës: Shikoni veten-e shihni të ardhmen

Moderne, bashkëkohore, arsimi efikas dhe të cilësisë, të përshtatura për nevojat, interesat dhe mundësitë e nxënësve në një klimë të sigurt dhe pozitive shkollore. Ne duam një shkollë ku mësimi do të realizohet duke përdorur ndihmat moderne të mësimdhënies dhe metodat interaktive. Me përvetësimin e shprehive dhe shkathtësive do të forcojë vlerat njerëzore dhe morale të një personi nga aftësitë e tyre fizike dhe intelektuale. Kjo do të krijojë një qëndrim aktiv dhe të përgjegjshëm ndaj vetes dhe mjedisit, e cila do të forcojë ndjenjën e jetës dhe të

paqes,tolerancës, mirëkuptimit dhe bashkëpunimitnë një shoqëri demokratike dhe civile Të rinjtë do të jenë në gjendje të përvetësojnë dituri, përvetësuar shkathtësitë dhe shprehite që do të jetë baza për të vazhduararsimimin e tyre dhe përfshirjen në punë. Ne duam një shkollë që vazhdimisht mëson. Ne duam një klimeshkollorenë të cilin ka marrëdhënie demokratike midis mësuesve, nxënësve, bashkëpunëtorët dhe tëpunësuarit e tjerë.

E gjithë kjo do të realizohet me arritjen e objektivave të mëposhtme:

- Motivimin e arsimtarit për të ndjekur trendet moderne në mësimdhënie, të përpiqen për mësuesin e kualitativ
- krijimin e kushteve për përdorimin e mjeteve mësimore moderne
- sigurimin e kushteve më të lartë për realizimin e mësimdhënies
- sigurimin e kushtevemë të lartë për realizimin e projekteve, përtej mësimdhënies
- përfshirja e mësimit kabinetik
- bashkëpunim me shkollat e tjera në vend dhe jashtë vendit,për përmirësimin e procesit edukativo-arsimor

3.Organizimi i punës në shkollë

Sipërfaqja e obijektit: 6 356 m/2

Sipërfaqja e oborrit të shkollës: 7 350 m/2

Sipërfaqe e fushave sportive dhe kënde lojrash 840 m/2

Viti i ndërtimit1972

Lloji i ndërtimit: materijal i fort

Metoda e ngrohjes në shkollë: nxemje qëndrore

Gjuha në të cilën zhvillohet mësimi: gjuhë shqipe dhe turke

Shkolla punon në ndrime:

Numëri i ndrimeve: dy, prej 7.30 dhe 13.30 ora

Numri i paraleleve: 42

Numri i nxënësve1174

Arsimimi:profesionale

3.1Struktura organizative dhe organizimi

- Organi menaxhues – Këshilli i Shkollës
- Organi udhëheqës– Drejtori i shkollës me zëvendës drejtorët
- Organet profesionale të shkollës: Këshilli i arsimtarëve dhe i paraleleve
- Aktivitet e arsimtarëve:aktivi letraro gjuhësor,aktivi shoqëroro humanitar ,aktivi matematiko natyror ,aktivi i lëndëve profesionale ekonomike dhe aktivi i lëndëve profesionale shëndetsore,
- Sekretari i shkollës i organizon:nikoqir-ekonomi, mjeshtëri teknik, pastrues

- Bashkëpunorë profesional: pedagogët, psikolog , defektolog dhe bibliotekisti
- Këshillat për prindërit i koordinojnë zv.drejtorat

3.2. Përgatitja materiale-teknike

Në kuadër të fondeve në dispozicion të siguruara nga Buxheti i RMV, si dhe të pasurive të fituara në bazë të të ardhurat vetjake, procedurat e tyre të zbatuara për prokurimin e mallrave, punimeve dhe shërbimeve me qëllim të përmirësimit të kushteve materiale dhe teknike për punë dhe mësim.Gjatë viteve të kaluara janë realizuar sanime dhe renovime në shkollë. Në këtë vit në të gjitha klasat ka banka te reja si dhe është përgatitur kabinet për manifestime publike i pajisur me mjete moderne teknologjike smart tabell dhe projektor . Koriderot e shkollës janë zbukuruar me vizatime me motive shkollore të inicuar nga nxënësit tanë të talentuar ne art figurativ. Në suaza të Ligjit për Arsimit të Mesëm,Qyteti i Shkupit siguron bileta mujore pa pagesë për nxënësit ndërse shkolla bën distribuimin e tyre.

Në bashkëpunim me Shërbimin Pedagogjik pranë MASH,nxënësit morën libra falas mirëpo ndjehet mungesë e librave të shumë titujve dhe gjuhëve mësimore.

3.3. Organizimi i procesit mësimor

Procesi edukativo arsimor në Sh.M.Q.Sh Cvetan Dimov-Shkup ,në vitin shkollor 2022/23 është realizuar sipas Programit vjetor për punën e shkollës i miratuar në mbledhjen e Këshillit të shkollës më 30.08.2022 .Programi I punës është propozuar nga Drejtori në Këshillin e arsimtarëve i konfirmuar në mbledhjen e 26.08.2022 ,në përputhje me Kalendarin e organizimit të vitit shkollor 2022/23 ,i sjellur nga Ministria e arsimit dhe shkencës së Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Mësimi në vitin shkollor 2022/23 filloi më 01.10.2022 dhe përfundoi në 09.06.2023 gjegjësisht më 18.05.2023 për nxënësit e vitit të katërt, kur ata realizuan 180 dhe nxënësit në vitet përfundimtare 166 ditë mësimore.

Pushimi dimërore filloi më 31.12.2022 dhe zgjati deri më 17.01.2023, ndërsa gjysëmvetori i dytë filloi me 18.02.2023.Pushimi veror filloi më 10.06.2023 dhe mbaroi më 31.08.2023.

Kalendari për punën e shkollës është në përputhje me Kalendarin e MASH-it për mënyrën e organizimit të vitit shkollor 2022/23 në shkollat e mesme publike .

Shkolla punon në dy ndërrime duke filluar nga ora 7:30 paradite dhe 13:30 deri në fund të vitit mësimor. Në një ndërrim mësojnë nxënësit e vitit të parë dhe të tretë, dhe në ndërrim tjetër viti i dytë dhe i katërt, pa marrë parasysh se cilën gjuhë i ndjekin mësimet.

Orarin e orëve e bën një mësues i punësuar në shkollë në bashkëpunim me drejtorin dhe zv.drejtorët. Kjo është bërë në gusht, në mënyrë që viti shkollor të fillon me një orar të përgatitur dhe i prezentuar paraprakisht te mësimitdhënësit.

Në SHMQSH “Cvetan Dimov“ – Shkup arsimohen në:

ARSIM PROFESIONAL me mësim në gjuhën shqipe dhe turke:

DREJTIMI SHËNDETSOR, vijim katërvjeçar, profile arsimore:

- 1.motër medicinale (të gjitha vitet) në gjuhën shqipe
motër medicinale (viti i parë) në gjuhën turke
- 2.teknik farmaceutik (të gjitha vitet) në gjuhën shqipe
3. teknik dhëmbësh.(të gjitha vitet),në gjuhën shqipe

DREJTIMI EKONOMIKO-TREGTARO JURIDIK me vijim katër vjeçar,profilet arsimore :

- 1.teknik ekonomik (të gjitha vitet)në gjuhën shqipe
teknik ekonomik (të gjitha vitet) në gjuhën turke
- 2.biznis administrator(të gjitha vitet) në gjuhën shqipe
3. teknik juridik(të gjitha vitet) në gjuhën shqipe

DREJTIMI EKONOMIKO-TREGTARO JURIDIK me vijim trevjeçar në gjuhën shqipe

Referent për shërbime të shitjes

Numri i nxënësve për klasë dhe profilet:

Arsim profesional: 42 paralele 1174 nxënës

| Drejtimi shëndetsor | | | Drejtimi ekonomik,tregtaro juridik | | | Gjithsej | | |
|---------------------|-----------------------|---------------------|---------------------------------------|-----------------------|---------------------|----------|------|----------|
| Viti | Numri i paraleleve | Numri i nxënësve | Viti | Numri i paraleleve | Numri i nxënësve | Viti | Par. | Nr.i nx. |
| I | 5 | 145 | I | 7 | 216 | I | 12 | 361 |
| II | 4 | 132 | II | 7 | 169 | II | 11 | 301 |
| III | 4 | 134 | III | 6 | 149 | III | 10 | 283 |
| IV | 4 | 126 | IV | 5 | 103 | IV | 9 | 229 |
| Gjithsej | 17 | 537 | | 25 | 637 | | 42 | 1174 |

3.4. Kuadri mësimor dhe jomësimor

| | Gjithsej | | Struktura e gjinisë dhe etnitetit të të punësuarave | | | | | | | | | |
|------------------------------------|----------|----|---|----|-------|----|------|---|------|---|----------|---|
| | M | f | Maqed | | Shqip | | Turq | | Romë | | Të tjerë | |
| | M | f | m | f | m | f | m | f | m | f | m | f |
| Numri i të punësuarave | 42 | 80 | 2 | 14 | 35 | 60 | 3 | 3 | / | 1 | 1 | 3 |
| Numri i kuadrit arsimor | 34 | 65 | 1 | 9 | 31 | 51 | 1 | 3 | / | | 1 | 2 |
| Numri i bashkëpunorëve profesional | 1 | 4 | / | 1 | 1 | 3 | / | / | / | / | / | / |
| Punëtorë Administrativ | / | 2 | / | / | / | 2 | / | / | / | / | / | / |
| Shërbimi teknik | 6 | 9 | 1 | 4 | 2 | 4 | 2 | / | / | 1 | / | 1 |
| Drejtori | 1 | / | / | / | 1 | / | / | / | / | / | / | / |

Shkalla e arsimit të punëtorve

| Arsimi | Numëri i të punësuarve |
|----------------------------|------------------------|
| Arsimi i lartë | 106 |
| Arsimi i lartë profesional | / |
| Arsimi i mesëm | 16 |

Struktura moshore e të punësuarve

| Vitet | Numëri i të punësuarve |
|-------------|------------------------|
| 20-30 | 10 |
| 31-41 | 58 |
| 41-50 | 28 |
| 51-60 | 22 |
| 60- pension | 4 |

Gjatë vitit shkollor kryhej mbi të gjitha lëndët mësimore të cilët kanë dhënë një plan program për arsimin gjimnazor dhe për profesionin drejtësi-ekonomik dhe tregtar. Brenda orëve, nxënësit marrin njohuritë e nevojshme teorike dhe praktike njohuri dhe aftësi për të marrë pjesë në mënyrë aktive në profesionin drejtësi-ekonomik dhe tregtar. Burimet njerëzore që e zbatojnë procesin edukativo-arsimor, është i përbërë nga Drejtori, zv.Drejtor, shërbimi profesional, mësuesit e lëndëve të përgjithëshme dhe lëndëve profesionale, bibliotekisti.

Gjatë vitit shkollor 2022/23, janë të drejtuara kryesisht të përdorin mësimdhënie interaktive duke përdorur metoda të ndryshme mësimore (dialogun, monolog, ilustrues, demonstrativ, diskutim, prezantim, metodë e hulumtimit), format e mësimdhënies (ballore, grupe, në çifte, individuale), teknikat mësimore (stuhia e të pyeturit, rrumbullakët, hyni në dy kolona, enigmat, gjëza, teknikë grup), përdorin një shumëllojshmëri të mjeteve mësimore dhe mjetet (harta, lineare, trupat gjeometrike, kalkulator, libra, bordi, gazeta mësimore, materialet për grupin).

3.5. Realizimi i Programit vjetor për punë

Duke analizuar punën e ShMQSh "Cvetan Dimov" në Shkup në vitin shkollor 2022/23, ne konkludojmë se parimet e përcaktuara në programin vjetor të punës realizohen pjesërisht në kuadër të mundësive hapësinore dhe stafit në dispozicion të shkollës. Programi Vjetor për punën edukativo- arsimore të ShMQSh "Cvetan Dimov" në Shkup është zhvilluar bazuar në analizën e

situatës dhe problemeve në arritjen e aktivitetit edukativo- arsimore dhe programet e detyrimit të përfshira në kurrikulat ekzistuese dhe të reja për arsimin e mesëm.

Në zhvillimin e programit janë marrë në konsideratë sugjerimet, opinionet dhe konkluzionet e ligjit të miratuar për punën edukativo-arsimore të shkollës, veçanërisht në përcaktimin e përgjegjësive të veçanta dhe detyrat nëpërmjet disa qëllimeve thelbësore:

-Puna e përgjithëshme edukativo-arsimore e shkollës të kuptohet në mënyrë që të përmirësojë suksesin për të gjitha lëndët

-Për të arritur një shkallë të lartë të monitorimit pedagogjike, menaxhimin dhe drejtimin në të gjitha fushat e aktiviteteve edukativo-arsimore, të angazhohet stafi pedagogjik dhe i gjithë kuadri edukativo-arsimorë në shkollë

-programe nga fusha e procesit edukativo-arsimor për të punuar në orë të kujdestarisë për shkathtësi jetësore

-Integrimi ndëretnik në arsim

-nxënësit e vitit të katërt janë vaksinuar sipas kalendarit për funksionimin e shëndetësisë e OSHP, dhe ligjërata u organizuan për parandalimin e pirjes së duhanit, alkoolit dhe substancave narkotike.

-Projekti Këshillimi prindërve dhe i nxënësve që kanë mungesa, sukses të dobët dhe sjellje jo të mirë, janë kryer gjatë gjithë vitit shkollor. Në grupin për këshillim morën pjesë 50 prindër, kryesisht vitet e para dhe të dyta të cilët shprehën shqetësimet e tyre në lidhje me fëmijët e tyre si dhe 62 nxënës me të njëjtat probleme. Zyra administrative ju ndihmon prindërve në këshillimin për tejkalimin e problemeve që është edhe qëllimi i këtij proekti.

-Integrimi i edukimit ekologjik në sistemin arsimor të Republikës të Maqedonisë së Veriut
Mësuesit në planifikimet e mësimin kanë orë me përmbajtje ekologjike, dhe i realizojnë, me qëllim në rritjen e ndërgjegjësimit ekologjik në mesin e të rinjve

3.6.Raport për suksesin dhe rregullshmërisë e nxënësve

Monitorimi dhe vlerësimi i arritjeve të nxënësve janë realizuar në bazë të Rregullores për monitorimin dhe vlerësimin e verifikimit, duke marrë provimet dhe përparimin e nxënësve në arsimin e mesëm (Gazeta zyrtare e RMV nr.39 / 02). Sipas dispozitave të njohurive dhe aftësive

të nxënësve në lëndë të caktuara Rregullave vlerësohen në përputhje me qëllimet dhe objektivat e përcaktuara nga programi mësimor. Koncepti modern i vlerësimit të substancave në një kontekstin e vlerësimit të procesit të përgjithshëm arsimor, niveli i përmbajtjes, niveli i aftësive dhe aplikimi i njohurive, niveli i zhvillimit të proceseve të mendimit dhe krijimit e qëndrimeve të përbashkëta.

Në këshillat e klasave pas çdo klasifikimitë periudhave të rregullta është bërë shqyrtimi dhe analizimi i suksesit, rregullshmëria dhe sjellja e nxënësve, të mbledhura të dhëna për të monitoruar vazhdimësinë e vlerësimit, një shumëllojshmëri të metodave didaktike, format dhe mjetet e vlerësimit të shkallës së përpunimit të kriterevetë vlerësimit , propozon masa për zhvillimin dhe përmirësimin e procesit mësimor për të përmirësuar suksesin.

Mund të konstatohet se sukcesi i nxënësve është në një rritje të vogël në krahasim me vitet e mëparshme.

Numrii përgjithshëm i nxënësve

Gjithësej: 42 paralele, 1174 nxënës

| Viti i I 12 paralele | | Viti i II 11 paralele | | Viti i III 10 paralele | | Viti i IV 9 paralele | |
|----------------------|------------|-----------------------|------------|------------------------|------------|----------------------|------------|
| meshkuj | femra | meshkuj | femra | meshkuj | femra | meshkuj | femra |
| 133 | 228 | 112 | 189 | 108 | 175 | 88 | 141 |
| 361 | | 301 | | 283 | | 229 | |

Me mësim në gjuhën shqipe :37 paralele ,1092 nxënës

| Viti i I-10 paralele | | Viti i II-10 paralele | | Viti i III 9 paralele | | Viti i IV 8 paralele | |
|----------------------|------------|-----------------------|------------|-----------------------|------------|----------------------|------------|
| meshkuj | femra | meshkuj | femra | meshkuj | femra | meshkuj | femra |
| 119 | 205 | 103 | 180 | 103 | 168 | 76 | 138 |
| 324 | | 283 | | 271 | | 214 | |

Me mësim në gjuhën turke-5 paralele-82 nxënës

| Viti i I-2 paralele | | Viti i II-1 paralele | | Viti i III 1 paralele | | Viti i IV 1 paralele | |
|---------------------|-----------|----------------------|----------|-----------------------|----------|----------------------|----------|
| meshkuj | femra | meshkuj | femra | meshkuj | femra | meshkuj | femra |
| 14 | 23 | 9 | 9 | 5 | 7 | 12 | 3 |
| 37 | | 18 | | 12 | | 15 | |

Nxënës me sukses pozitiv dhe negativ

| Suksesi | Shkëlqyeshëm | | Shumë mirë | | Mire | | Mjaftueshem | | Përserites | |
|---------------------|--------------|------------|------------|------------|------------|------------|-------------|------------|------------|--|
| | | % | | % | | % | | % | | |
| Viti I -rë361 nx. | 80 | 22% | 70 | 19% | 132 | 37% | 79 | 22% | / | |
| Viti II -të.301 nx. | 77 | 26% | 61 | 20% | 108 | 36% | 55 | 18% | / | |
| Viti III-të 283 nx. | 93 | 33% | 28 | 10% | 104 | 37% | 58 | 20% | / | |
| Viti IV-të.229 nx. | 78 | 34% | 48 | 21% | 74 | 32% | 29 | 13% | / | |
| Gjithsej 1174 nx. | 328 | 28% | 207 | 18% | 418 | 35% | 221 | 19% | / | |

Rang lista e suksesit sipas klasave

| n.r. | Viti i parë | | Viti i dytë | | Viti i tretë | | Viti i katërt | |
|-----------------|-------------|-----|-------------|-----|--------------|-----|---------------|-----|
| 1 | 1/12 | 4.7 | 2/1 | 4.2 | 3/3 | 4.8 | 4/2 | 4.4 |
| 2 | 1/1 | 4.2 | 2/2 | 4.1 | 3/1 | 4.2 | 4/3 | 4.1 |
| 3 | 1/3 | 4.0 | 2/3 | 4.0 | 3/2 | 4.1 | 4/4 | 4.0 |
| 4 | 1/2 | 3.7 | 2/4 | 3.6 | 3/4 | 3.9 | 4/1 | 3.8 |
| 5 | 1/4 | 3.6 | 2/5 | 3.6 | 3/8 | 3.2 | 4/6 | 3.2 |
| 6 | 1/11 | 3.4 | 2/6 | 3.6 | 3/10 | 3.2 | 4/7 | 3.2 |
| 7 | 1/8 | 3.3 | 2/8 | 3.5 | 3/5 | 3.1 | 4/8 | 3.2 |
| 8 | 1/6 | 3.3 | 2/7 | 3.1 | 3/6 | 3.1 | 4/5 | 2.9 |
| 9 | 1/5 | 3.1 | 2/10 | 3.0 | 3/7 | 2.8 | 4/10 | 2.6 |
| 10 | 1/7 | 2.7 | 2/11 | 2.8 | 3/9 | 2.3 | / | / |
| 11 | 1/9 | 2.6 | 2/9 | 2.5 | / | / | / | / |
| 12 | 1/10 | 2.3 | / | / | / | / | / | / |
| Suksesi mesatar | 3.5 | | 3.6 | | 3.6 | | 3.0 | |

Nga tabela mund të vërehet se sukses më të lartë të vitet e para ka arritur paralelja 1/12 nga drejtimi shëndetësor-mçtëe medicinale për të parën herë në gjuhën turke, në vitet e dyta sukses më të lartë ka arritur paralelja e 2/1 drejtim shëndetësor gjithashtu motër medicinale, te vitet e treta sukses më lartë ka arritur e 3/3 drejtim shëndetësor-teknik farmaceutik dhe te vitet e katërta gjithashtu drejtim shëndetësor e 4/2 ka arritur sukses më të lartë.

Sukses më të dobët ka paralelja 1/10 nga drejtimi drejtimi ekonomik –juridik me arsim tre vjeçar, profili arsimor referent i shitjes, mesim në gjuhën shqipe me mesatare 2,3 nga vitet e dyta sukses më të ulët ka paralelja 2/9 nga drejtimi ekonomik-profil referent për shërbime të

shitjes me mesatare 2,5 , nga vitet e treta paralelja 3/9 ka sukses të ulet me mesatare 2.3 nga drejtimi ekonomik-profilu referent per shitje në gjuhën shqipe dhe nga vitet e katërta sukses të ulet ka paralelja 4/10-teknik ekonomik me mesatare 2,6 mesim ne gjuhen turke.

Suksesi mesatar sipas drejtimeve dhe profileve arsimore

| Drejtimi arsimor | Viti i I-rë | Viti i II-të | Viti i III-të | Viti i IV |
|-------------------------------------|-------------|--------------|---------------|-----------|
| Drejtimi shëndetsor | 4.0 | 4.0 | 4.2 | 4.0 |
| Drejtimi ekonomiko-tregtaro juridik | 3.0 | 3.2 | 3.0 | 3.0 |
| Suksesi mesatar per vite | 3.5 | 3.6 | 3.6 | 3.5 |
| Suksesi mesatar i shkollës 3.55 | | | | |

Nga tabela mund te vertetojme se nxenesit e drejtimet shendetesor te të gjitha vitet kanë treguar sukses dukshem më të mirë se sa drejtimet ekonomike dhe tregtare e cila eshte pozitive por suksesi mesatar i shkolles eshte ne ritje nga viti i kaluar (3.44)

Ne fillim te vitit shkollor pothuajse te gjithe mesimdhenesit (nga drejtimet e pergjithshme arsimore) realizuan kontrollim të njohurive të nxënësve të viteve të para, me qellim që të kenë një pasqyrë paraprake të njohurive të mëparshme, gjegjesisht të dinë se me cfar fondi të njohurive kanë ardhur në arsimin e mesëm. Rezultatet janë të kenaqshme në drejtimin shëndetsor përderisa në drejtimin ekonomik – juridik dhe tregëti nuk janë edhe aq të mira.

Rregullshmëria dhe mungesat e nxënësve

| Profili arsimor | Viti I-rë | | Viti II-të | | Viti III-të | | Viti IV-të | |
|---------------------------------------|--------------------------|---------|----------------------------|---------|----------------------|---------|-----------------------|---------|
| | Të ars. | Paarsye | Të ars. | Paarsye | Të ars. | Paarsye | Të ars. | Paarsye |
| Shëndetsi dhe mbrojtje sociale | 1229 | 178 | 1306 | 486 | 372 | 332 | 1888 | 441 |
| Ekonomi,juridik dhe tregti | 2537 | 1384 | 1359 | 578 | 765 | 462 | 1562 | 457 |
| Gjithsej | 3766 | 1562 | 2665 | 1064 | 1137 | 794 | 3450 | 898 |
| Mesatarja sipas viteve | 5328 14 m. Për nxënës | | 3729 12 për nxënës | | 1937 6 për nxënës | | 4348 18 për nxënës | |
| Gjithsej mungesa në nivel të shkollës | 15342 | | Mesatare për tërë shkollën | | 13 për nxënës | | | |

Mund te konstatojme se mungesa nga mesimi është më e lartë te vitet e para, ndersa me e ulet eshte te vitet e treta. Në lidhje me numrin e madh të mungesave te vitet e para janë marrë masa duke filluar nga kujdestarët e klasave me shqiptimin e masave pedagogjike dhe këshillimi i i nxënësve dhe prindërve nga shërbimi psikologjik i shkollës.

Masat pedagogjike të shqiptuara:

| Viti | Kujdesari i klasës | Këshilli i paraleleve | Drejtori | Këshilli i arsimtarëve parapërfundim | Këshilli i arsimtarëve Përfundim |
|----------|--------------------|-----------------------|----------|--------------------------------------|----------------------------------|
| I | 6 | 7 | 11 | 1 | 3 |
| II | 3 | 9 | 3 | 2 | 1 |
| III | 5 | 2 | 4 | / | / |
| IV | 10 | 8 | 3 | / | / |
| Gjithsej | 24 | 26 | 21 | 3 | 4 |

Nga sukcesi i arritur organet udhëheqese, aktivet dhe keshillat e viti per dallim nga vitet e kaluara jane me te kenaqshme sepse sukcesi mesatar i shkolles eshte permiresuar, prandaj duhet qe te gjithë te perpiqemi per te arritur dituri kualitative dhe afatgjate, notimi te jete me objektiv. Tendencioni paraqet edhe stimulim të angazhimit në menyrë të kontinuar gjatë gjithë vitit shkollor, me vërejtje që duhet në menyrë më intenzive edhe më teper të punohet në përmirsim të rregullshmerisë së nxënësve.

Në drejtim të përmirësimit të procesit edukativo arsimor në mënyre intenzive është puna me prinderit dhe me kujdestaret e nxenesve, mbahen keshillime te parapara me prinder,mbledhje te keshillit te prinderve,cdo kujdestar i paraleles dhe mesimdhenes lendor ne korniza te diteve te caktuara realizon takime me prinderit, gjegjesisht kujdestaret e nxenesve.

Ne pajtueshmeri me ndryshimet dhe plotesimet e Ligjit per arsim te mesem, ne shkolle jane realizuar keshillime te prinderve dhe nxenesve qe kane 3 ose me teper nota te dobeta dhe me teper se 10 mungesa pa arsye.

3.7. Shpërblime dhe lavdrata

Këshilli i arsimitareve me propozim të kujdestarëve të klasave edhe këtë vit shkollor ndau shpërblime, lavdrata dhe dhurata modeste për nxënësit që kanë kontribuar për afirmimin e shkolles para opinionit.

Si nxënës më të mirë të vitit të IV (katert) për vitin 2022/23 janë:

- nga paralelja e drejtimit shëndetësor në gjuhën shqipe Semra Kamberova nga klasa 4/1 dhe Rumesa Avdi nga klasa 4/1- moter medicinale
- Nga paralelja e drejtimit ekonomik juridik dhe tregetar nxënësja Fatina Iseni nga klasa 4/6, Albina Tairi nga klasa 4/8- teknik juridik

„Nxenes i gjenerates” :

Zerina Çupi- nga paralelja 4/1 drejtimi shëndetësor, profili arsimor moter medicinale

- Në fund të vitit shkollor 2022/2023 me propozim të kujdestarëve të klasave për “nxenes më të mirë” për vitet e para, të dyta dhe të treta Këshilli i arsimitareve i zgjodhi:
- Nga viti i I (parë) Ilfet Sejdi 1/1 motër medicinale, Merdije Abdi nga klasa 1/3 teknik farmaceutik, Merjem Isenovska nga 1/12-motër medicinale në gjuhën turke, Rumesa Ramadani nga klasa 1/6-teknik ekonomik, Melda selmanova nga 1/11 -teknik ekonomik në gjuhën turke.
- Nga vitet e II (dyta) Vlerona Mustafa nga e 2/1 motër medicinale, Amra Çupi nga e 2/3 teknik farmaceutik, Amela Arifi nga e 2/6 teknik ekonomik dhe Mrva Jusufi nga 2/11 teknik ekonomik, mësim në gjuhën turke..
- Nga vitet e III (treta) : Urata Murseli nga 3/1, Rejhane Sefa nga 3/3-teknik farmaceutik, fatime Rushiti nga klasa 3/4-teknik dhëmbësh, Nora Grubi nga 3/5-teknik ekonomik dhe Kanita Berisha nga 3/8-teknik juridik.

3.8 Përmbajtje të programuara nga shkolla

Në suaza të orëve të lira të nxënësve në shkollë nxënësit nga arsimit i reformuar profesional të viteve të para, të dyta, të treta dhe të katërta ishin të kyçur në aktivitete projektuese në disa fusha sipas udhëzimeve nga Ministria e arsimit dhe shkencës të Republikës të Maqedonisë së Veriut dhe QAPT. Në këtë kontekst përmbajtet e programura nga shkolla ishin pjesë e fondit javor të orëve dhe të orarit për mësim. Ato u realizuan në këto klasa në fusha të ndryshme mësimore:

- Trashëgimia botërore në duart e të rinjve: prej klasë 1/1 deri 1/12 me mësim katërvjeçar
- Planifikimi i karrierës: prej 2/1 deri më 2/11 gjithashtu me mësim katërvjeçar
- Përgatitje për punësim dhe punë: prej 3/1, 3/2, 3/3, 3/4, 3/7 dhe 3/8
- Kompania e nxënësve-Praktikë sipërmarrëse për të rinjtë: 3/5 dhe 3/6

- Shkathtësi prezentuese: prej 4/1 deri 4/10

3.9 Raport për maturën shtetërore dhe përfundimtare

Matura shtetërore dhe provimet përfundimtare janë realizuar në dy afate: afati i qershorit dhe afati i gushtit. Paraqitja u realizua sipas agjendës së planifikuar, si dhe aktivitete tjera të planifikuara, duke filluar nga muaji Tetor- përzgjedhja e temave për detyrën projektuese. Paraqitja në Dhjetor, Janar – paraqitja në mënyrë elektronike në bazë të të dhënave të QSHP dhe verifikimi i listave të kandidatëve, pregaditja e aktiviteteve të projektit dhe në Prill mbrojta e detyrave projektuese, provimet eksterne dhe interne janë realizuar sipas kalendarit për punën e shkollës për vitin shkollor 2022/23. Rezultatet u publikuan sipas afatit.

Rezultatet e maturës shtetërore dhe provimeve përfundimtare në të gjitha gjuhët mësimore.

| Gjuha mësimore | Lloji i arsimit | Maturë shtetërore | | Provim përfundimtar | | Pa diplomë | |
|----------------|-------------------|-------------------------------------|-----------------|---------------------|---------|------------|---------|
| | | Të rregullt | Me korespodencë | Te rreg. | Me Kor. | Te rreg.. | Me Kor. |
| Gjuhë shqipe | Arsim profesional | Kanë kaluar 219 | 7 | 33 kanë kaluar | 90 | | |
| | | Nuk kanë kaluar / | 14 | / | | | |
| | | | | | | | |
| Gjuhë turke | Arsim profesioanl | Kanë kaluar 10 Nuk kanë kaluar 4 | | 4 kanë kaluar | | 4 | |
| | 2022/23 | | | | | | |

Raporti i suksesit nga matura shtetërore

| Lëndët | 5 | 4 | 3 | 2 | 1 | gjithsej | mesatarja |
|-------------------------------------|-----|-----|----|----|----|----------|-----------|
| Gjuhë shqipe | 14 | 145 | 48 | 1 | 10 | 218 | 3,69 |
| Makedonski jazik | / | / | 5 | 4 | / | 9 | 2,55 |
| Gjuhë turke | / | 2 | 7 | 3 | / | 12 | 2,91 |
| Gjuhë angleze | 13 | 68 | 71 | 44 | / | 196 | 3,25 |
| Biologji | 125 | 24 | 2 | / | / | 151 | 4,81 |
| Sëmundjet kirurgjike me përkujdesje | 33 | 15 | 22 | 4 | / | 74 | 4,0 |
| Farmakognozi | 22 | 8 | / | / | / | 30 | 4,73 |
| Ura dhe koronka | 10 | 15 | 2 | 3 | / | 30 | 4,06 |
| Histori | 9 | 8 | 29 | 24 | / | 70 | 3,82 |
| Marketing | 10 | 9 | 24 | | / | 43 | 3,67 |
| Punë administrative të zyles | 3 | / | 8 | 2 | / | 13 | 3,30 |
| Korespodenca | 3 | 3 | 11 | / | / | 17 | 3,52 |
| | | | | | | | |

4.Realizimi i mësimit

Mësimenë të gjithalëndët(teorike dhepraktike)-Mësimi teorik zbatohet sipas planeve dhe programeve të parapara mësimore, në arsimin e përgjithshëm dhe lëndët e specializuara (teknike), në përputhje me planin arsimor për arsim të gjimnazit ,për arsimin profesional në drejtimin ekonomiko-tregtaro juridik dhe drejtimin shëndetsor.Mësuesit me kohë i përgatitin planifikimet vjetore dhe tematike dhe të përmbahen në realizimin e tyre. Në planifikimin dhe zbatimin e tij parashikojnë Eko përmbajtje.

Mësimi praktik u referohet nxënësve të cilët e ndjekin mësimin në arsimin e specializuar (ekonomik të drejtësisë dhe të tregtisë) dhe ai është i ndarë në dy pjesë: njëra pjesë realizohet në hapësirat shkollore. Pjesa tjetër mund të realizohet në sipërmarrje ose shoqëri tregtare.

Këtë vit shkollor është realizuar mësimi praktik në firmat tregtare ,Super Kompani,Hepimarket,Rabati trejd,Kiper dhe Gipsimobilia.Mësimi praktik për nxënësit e drejtimit shëndetsor është realizuar në kabinetet shkollore dhe në organizata shëndetsore përkatëse.

U realizua edhe fondi i paraparë i orëve të lëndëve mesimore si edhe numri i diteve mesimore të parapara gjithashtu të shkurtuara në 180 orë për nxënësit e viteve të para,dyta dhe treta dhe 166 per nxenesit e viteve të katërta

I tërë procesi është kryer nga dokumentet programore për aktivitetet arsimore në arsimin e mesëm, siguruar nga MASH, Departamenti i Arsimit të Qytetit të Shkupit, BZHA dhe QAPT.

Përdorimi i TIK-ut në mësimdhënie

Gjatë këtij viti shkollor, mësuesit e TIK në mësimdhënie kishte në dispozicion 13 klasa me kompjutera funksionale. Ata e kuptuan këtë udhëzim me emërimin e orëve në këto klasa. Laptopët për të cilët mësimdhënësit janë përgjegjës përdoren në mënyrë optimale. Ata i përdorin ato për të përgaditur planet e tyre vjetore, tematike dhe ditore, pregaditje të testeve të diturisë, evidencë në klasë, për futjen e të dhënave në e-ditarin, shfrytëzim të internetit etj.

Mësimi plotësues dhe shtues

Në fillim të vitit shkollor, mësuesit përgatisë teste nga lëndët e përgjithëshme për të përcaktuar nxënësve para njohurit kryesisht nga viti i parë, ose për të gjetur se si shumë dijeni paraprake të nxënësve që vijnë në shkollë të mesme. Për shkak të asaj gjatë tërë procesit edukativo arsimor do tu mundësohen forma të ndryshme të ndihmës në tejkalimin e përmbajtjeve programore, të përshtatura në aftësitë dhe mundësitë e tyre specifike, nëpër punën në grupe dhe atë individuale, të drejtuaranë thelbin e përmbajtjes, metodat e të mësuarit të sukseshëm, angazhimin e organizuar të nxënësve, materilet e ndryshme për punë të pavarur dhe ngjashëm. Gjithashtu, mësimi plotësues realizohet edhe për përgatitjen e nxënësve të cilët dërgohen në riprovime dhe në provimet e vitit. Për atë qëllim, mësimdhënësit pregadisnin program për punë, të cilën e dorëzojnë deri më 20 shtator, dhe në të njëjtën kohë ata paraqesin kushtet për mirëmbajtjen e tij.

Për nxënësit që gjatë mësimin të detyrueshëm tregojnë ritje të interesit për disa disiplina të caktuara, organizohet mesim shtues. Mesimi shtues realizohet në bazë të programit që nënkupton zgjerim dhe thellim të përmbajtjeve të lëndeve të caktuara në fusha të ndryshme, të cilat kontribuojnë në zhvillim të talentit dhe interesit të nxënësve.

Për fat të keq interesi për mesim shtues është i vogël sepse nxënësit kanë numër të madh të fondit javor dhe ditore të orëve të detyrueshme,

Prandaj për shkak të gjitha këtyre arsyeve realizimi i orëve shtesë është i veshtiresuar. Orët shtesë dhe plotësuese janë të rregulluara në bazë të Ligjit për shkollat e mesme.

5.Proektet dhe aktivitetet jashtëmësimore

Gjatë vitit mësimor 2022/23 u realizuan shumë aktivitete jashtëmësimore sipas interesit të nxënësve dhe sipas udhëzimeve nga Qyteti i Shkupit:

| n.r | Proekti | Përshkrimi i aktivitetit | Përgjegjës | Koha e realizimit |
|-----|--|--|--|-------------------|
| 1. | EMIS | Sistem elektronik | Eleonora Cikalova | Tërë vitin |
| 2 | Ditari elektronik | Sistem elektronik | Eleonora Cikalova Arta Zimeri | Tërë vitin |
| 3. | Matura shtetërore | Organizimi dhe realizimi i provimeve eksterne shtetërore dhe provim përfundimtarë | Vullnet Rexhepi Ridvan Mustafa Berina Jakupi Elvisa Nuredin | Tërë vitin |
| 1. | Dita e paqës | Grup nxënësh në bashkëpunim me Ambasadën e fëmijëve Megjashi-Shkup organizuan marshin e paqës nëpër rrugët e qytetit me porosi paqësore | Valdeta Huseini Naile Tairi | 21 shtator |
| 2. | Open up your options | Grup nxënësh në bashkëpunim me Qendrën për të rrinjtë KRIK i promovuan profilet në drejtimin shëndetsor se bashku me shkollat tjera të mesme | Berina Jakupi Ajla Bilal | 5 tetor |
| 3 | Digitalizimi, efektet pozitive dhe negative të saj | Ligjerata nga specialistë nga Instituti për shëndet mental për fëmijë dhe të rrinj..Mladost,, | Shërbimi profesional | 12 nëntor |
| 4. | Aktivitet humanitar-Gjakdhënie | Aktivitet humanitar - gjakdhënie ku u grumbulluan 18 njësi gjaku-Kryqi i kuq - Shkup | Ajtene Kadriu Ajdini | 18 nëntor |
| 5. | Viti i Ri | Volonterë nga Klubi për edukimin e të rrinve nga Kryqi i kuq së bashku me nxënësit tanë shpërndanë 65 pako për | Ajtene kadriu Ajdini | 27 dhjetor |

| | | | | |
|-----|--|--|---|---------------------|
| | | fëmijë në familje skamnore në f.Luboten | | |
| 6. | Dita e prozës | Ligjerata nga shkrimtarja Mimoza Mustafai Jonuzi i promovimi i romanit „Heshnja vret,, | Arsimtarë nga aktivi letrar | 9 shkurt |
| 7. | Esse-u më i mirë | Në bashkëpunim me Qendrën e të rrinjve „Akabe „u organizua gara për ese më të mirë ku mërën pjesë të gjitha shkollat e mesme me mësim në gjuhën shqipe.Nxënësje Zerina Çupi nga klasa 4/2 u shpërblye me vendin e dytë. | Makfire Shazivari Sadete Nuhii | 9 shkurt |
| 10. | Kampi i inovacioneve | 8 nxënës nga paralelet të drejtimit ekonomik morrën pjesë në gara dyditëshe në kampin e inovacioneve „Junior Achievement,,ku propozuan si të prodhohen produkte me mbetje organike dhe u shpërblyen me vendin e parë dhe të dytë sipas kategorive. | Adrian Etemi Alajdin Demiri | 20 shkurt |
| 11. | Olimpiada e ekonomistit | Gara në lëndët ekonomike në nivel shkollor ,nxënës nga drejtimi ekonomik | Arsimtarë nga aktivi profesional ekonomik | 27 shkurt 1 mars |
| 12. | Të ushqyerit e shëndetshëm | Ligjerata edukative për ushqim të shëndetshëm dhe dietikë dhe ndikimi i ushqimit në shëndetin mental,pjesmarës specialistë dieteloge Valbona Kadriu dhe psikologjia klinike Edlira Destani | Shërbimi profesional | 1 mars |
| 13 | Evakuim dhe mbrojtje nga fatkeqsitë natyrore | Të gjithë të punuarit dhe nxënësit e viteve të para dhe të treta morrën pjesë në ushtrimin për preventivë dhe evakuim nga fatkeqsitë natyrore.Ushtrimi u realizu në tre faza në bashkëpunim me Kryqin e kuq -Shkup | Grup arsimtarësh dhe Kryqi i kuq - Shkup | 3 mars |
| 14 | Java e sportit | Gara në futboll të vogël ku | Samet Sinani | 1-6 mars |

| | | | | |
|-----|-----------------------------------|--|--------------------------------|------------|
| | | morën pjesë të gjitha klasat në kategorinë junior dhe senior. Vendi i parë 4/10 senior Vendi i parë 2/6 junior | Fadil Qamili | |
| 15 | &-Marsi -Dita e mësuesit | U shënua Dita e mësuesit me program të begatshëm kulturor .letrar dhe artistik i organizuar nga Bashkësia e nxënësve të shkollës. | Aktivi letrarogjuhsor | 7 mars |
| 16. | Intelegjenca emocionale | 6 grupe me nga 5 nxënës realizuan ligjerata për Intelegjencën emocionale në formë të garimit.U trajtuan tema të ndryshme dhe si temë më e mirë u zgjodh tema,„Vetëdija,, | Berina Jakupi Ajla Bilal | 8- 15 mars |
| 17. | Humaniteti nuk ka kufij | Klubi për edukim dhe preventivë në bashkëpunim me Kryqin e kuq -Çair ,mblodhën dhe shpërndanë pako me ushqim në 12 familje skamnore | Ajtene Ajdini Kadriu | 20 mars |
| 18 | Dita e ekologjisë | Në hapsirat e shkollës u organizua aksion ekologjik për pastrimin dhe rregullimin e oborit të shkollës me qëllim ngritjen e vetëdijes ekologjike dhe mbrojtjen e ambientit jetësor | Të gjithë kujdesarët e klasave | 21 mars |
| 19. | Dita e ekologjisë | Një grup nxënësish në bashkëpunim me Qytetin e Shkupit dhe NP Parqe dhe gjelbërime mërën pjesë në aksion për mbjelljen e fidaneve të reja në Kopshtin yoologjik-Shkup | Jasmina Dimitrievska | 22 mars |
| 20 | Arsimimi dhe toleranca ndëretnike | Sh.M.Sh për rehabilitim dhe arsimim „Shën.Naum Ohridski „Sh.M.Q.Sh „Cvetan Dimov,,dhe Sh.M.Q.Sh.,„Orce Nikollov -organizuan tregun,e përbashkët me punime kreative | Jasmina Dimitrievska | 5 prill |

| | | | | |
|----|------------------------------------|--|--|----------|
| | | të përgatitur nga art sesioni dhe puntori kreative të tekstilit | | |
| 21 | Ditë historike | Vizita e Arkivës së R.M.V,arsimtari i historisë me nxënës të viteve të para | Burhan Murtezani | 6 prill |
| 22 | Promovimi i shkollës | Nxënës dhe arsimtarë të profilit teknik dhëmbëdh e promovuan pshkollën dhe profesionin para nxënësve të shkollës fillore „Lirija,, | Arbnora Kajolli Mirvete Berisha | 12 prill |
| 23 | Arsimimi dhe toleranca ndëretnike | Shkollat partnere SH.M.Sh për Rehabilitim dhe arsimim „Shën .Naum Ohridski,,dhe Sh.M.Q.Sh „Cvetan Dimov,, - Shkup,realizuan puntori multietnike për nxitjen dhe avansimin e multikulturalizmit | Jasmina Dimitrievska | 12 prill |
| 24 | Panairi i librit | Vizitë në panairin e librit nga nxënësit e viteve të treta me arsimtarine gjuhës shqipe | Lindita Murseli | 9 maj |
| 25 | Dita ndërkombëtare e Kryqit të kuq | Për Ditën ndërkombëtare të Kryqit të kuq u mbajt manifestimi Oskari i humanizmit ku u shpërndanë lavdrata dhe shkolla jonë u shpërblye me çmimin Oskar për humanizëm me mentor arsimtare Ajtene .A. Kadriu | Ajtene A.Kadriu | 10 maj |
| 26 | Dita ndërkombëtare e infermierisë | Panel -diskutim për rolin dhe rëndësinë e infermierisë në sitemin shëndetsor | Valdeta Huseini Naile Tairi Nuran Aliademi | 12 maj |
| 27 | Gara për ndihmë të shpejtë | Kruqi i kuq-Çair organizoi gara për dhënien e ndihmës së shpejtë ku morë pjesë 15 grupe në kategorinë më të rrinj dhe të rrinj.Nxënësit tanë u shpërblzen me vendin e parë në kategorinë të rrinj. | Ajtene A.Kadriu Besa Lusjani | 20 maj |
| 28 | Ditë e hapur në shkollë | Promovimi i të gjitha profileve arsimore para nxënësve dhe prindërve nga shkollat | Të gjithë kujdestarët e klasave | 31 maj |

| | | | | |
|--|--|---|--|--|
| | | fillore.Musafir nderi kishim Kryetarin e R.M.V Stevo Pendarofskin ,si ish nxënës i kësaj shkolle dhe Kryetarin e komunës së Çairit Visar Ganiu. | | |
|--|--|---|--|--|

Bashkëpunimi dhe vizita e Institucioneve shtetërore dhe subjekteve private

Në kuadër të profesionit ekonomik dhe tregtar ligjore, mësimdhënësit e lëndëve profesionale të bashkëpunojë me subjekte të tilla si Regjistri Qendror i RMV, Aktivi shëndetsor bashkëpunoi me Kryqin e kuq Çair dhe nxënës morën pjesë në aksionin humanitar për dhurim të gjakut më 08 dhjetor në hapsirat e shkollës sonë,dhe projekti Muaji i varferise ne te cilen u angazhuan nxenesit dhe aktivistet e Kryqit te Kuq me aktivitete humanitare

6. Puna e organeve udhëheqëse dhe profesionale

6.1. Këshilli i Shkollës

Gjatë vitit shkollor 2022/22, Këshilli i shkollës ka mbajtur 9 takime ku janë diskutuar dhe miratuar:

- Programi vjetor i punës së shkollës për vitin shkollor që vijon dhe miratimi i Raportit vjetor të punës së shkollës për vitin e kaluar,
- Propozon plan financiar vjetor deri te Ministria ,propozon faturë përfundimtare
- Sjell plan vjetor për të hyra publike
- Sjell vendim për realizim të rregjistrimit
- Vendos për ankesat e të punësuarve ,nxënësve dhe prindërve,
- Formon Komision për shqyrtimin e ofertave për ekskurzione shkollore,
- Sjell vendim për ekskurzion shkollor
- Shqyrton edhe çështje tjera të verifikuara sipas statutit të shkollës
- Mbajtja e mbledhejs së formimit të ekipi inkluziv

Anëtarë të KSH:

Themelues:Arjeta Aliu,Nazmije Bela,Sevdair Aziri

MASH:Ajla Bushi

Perfaqesues I odes ekonomike:Orgest Aliti

Prinder:Shehnaz Shaini,Mensur Curri и Shaip Jakupi
ArsimtareRejhan Sopa,Hamide Ibraimi,Arbnora Ibrahimi
Kryetar i KSH:Afrim Sulejmani

6.2..Këshilliarsimtarëve

Gjatë vitit shkollor 2022/23 janë mbajtur 11 mbledhje nga Këshilli i arsimtarëve ,ku u shqyrtuan disa aspekte të procesit mësimor:

- suksesi dh esjellja e nxënësvesipas periudhave kualifikuaese
- propozime dhe masa konkrete për ngritjen e suksesit dhe përmirsimin e sjelljes
- shqiptimi i masave pedagogjike për nxënësit
- çështje aktuale nga mësimi dhe nga aspekti profesional
- çështje tjera të lidhura me punën në shkollë

6.3.Këshillat e viteve dhe paraleleve:

- e organizon dhe realizon mësimin në përgjithsi,i përmbledh rezultatet nga puna e nxënësve sipas periudhave kualifikuese
- i verifikon notat e gjysmëvjetorit dhe notat përfundimtare për fundvit,sjelljen e nxënësve dhe shqipton masa pedagogjike
- bashkëpunon me Këshillin e prindërve
- proponon masa në Këshillin e arsimtarëve për tejkalimin e mangësive eventuale në punën shkollore

6.4.Këshilli i prindërve

Në drejtim të përmirimit të punës edukativo-arsimire është nxitur bashkëpunimi me prindërit dhe kujdestarët e tyre,janë realizuar mbledhjet prindore të parapara,mbledhjet e Këshillit të prindërve,çdo kujdestar dhe arsimtar lëndor gjatë ditëve për takim me prindërit realizuan bashkëpunim të ndërsjelltë.

Gjatë vitit shkollor 2022/23 janë realizuar 3 takime me prindërit në të cilat u diskutua për suksesin e nxënësve,zvoglimin e mungesave dhe përmirsimin e disiplinës së nxënësve.

6.5.Kujdestarët e klasave

Gjatë tërë vitit mësimor e ndoqën punën edukativo-arsimore të nxënësve,u kujdesën për realizim të rregullt të mësimimit,miratuan mungesë në mësim për nxënësit,lavdëruan dhe shqyrtuan masa pedagogjike dhe bashkëpunuan me prindërit.

6.6. Ekipi menaxhues i shkollës

Ekipi menaxhues i shkollës përbëhet nga Drejtori dhe ndihmësit e drejtorit. Ekipi menaxhues i udhëhequr nga Drejtori si një organ udhëheqës është përgjegjës për ligjshmërinë e shkollës.

Ekipi i menaxhimit duke nxitur punën në grupe përpiqet të arrijë qëllimin përfundimtar: përmirsimin e punës edukativo arsimore dhe rritjen e rezultateve mësimore në shkollë.

Anëtarët e ekipit menaxhues, secili brenda kompetencave të saj kontribuon për:

- përpilimin e Programit vjetor të punës së shkollës
- përpilimin e planit për punë të Këshillit të arsimtarëve
- përzgjedhjen e arsimtarëve
- përgatitje dhe udhëheqje të Këshillit të arsimtarëve
- vizita e orëve mësimore
- organizimi dhe koordinimi i punës në shkollë
- ndjekja e punës edukativo –arsimore dhe kujdesi për realizimin total të programeve arsimore
- kujdes për udhëheqjen e rregullt të evidencës pedagogjike
- ngritje profesionale e arsimtarëve
- ndjekjen e arsimtarëve dhe nxënësve dhe propozon masa për përmirsimin e punës
- analiza dhe ndjekja e suksesit dhe sjelljes së nxënësve
- avansimin e bashkëpunimit me prindërit
- vizita e seminareve dhe këshillimeve

6.7. Aktivitet

Aktivitetet profesionale aktivitetet e tyre i orientuan në përmirsimin dhe adaptimin e planit programor sipas aftësive dhe moshës së nxënësve, modernizimin e mësimdhënies dhe standardizimin e vlerimit, zbatimin e mësimin modern duke kyçur teknika të reja mësimore, bashkëpunim me prindërit, bashkëpunimin ndërkolegial, avancimin profesional duke ndjekur seminare , trajnime , ligjerata e tjera.

7. Burimet financiare

Mjetet për finansimin e shkollës janë siguruar nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut. Mjetet nga Buxheti , Qyteti i Shkupit i shpërndan nëpërmes bllok donacioneve dhe grante të shkollave të mesme për sigurimin e realizimit të procesit edukativo arsimore, në përputhje me standardet e verifikuara dhe normative.

Shkolla siguron të ardhura nga vetë shkolla duke dhënë shërbime shkollore kandidatëve me korespodencë,dhënia me qera e objekteve shkollore.Këto të ardhura janë përcaktuar për avansimin,modernizimin dhe zhvillimin e veprimtarisë shkollore.

8. Bashkëpunimi me mediat

Shkolla komunikimin publik dhe promovimin e shkollës e realizon në mënyrat e mëposhtme: institucionet në fushën kulturore, institucionet në fushën e arsimit, OJQ-të, shoqatat sportive.

Gusht. 2023

Drejtor:Sakip Axhami

